

PROCEDURA E KËRKESËS

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është Autoriteti Qëndror i vetëm në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit vendas dhe ndërvendas.

KSHB në veprimtarinë e tij ka synuar të garantojë interesin më të lartë të fëmijëve të deklaruar të braktisur për të siguruar familje të përshtatëshme dhe të denja në mënyrë që të krijohen kushte për mirërritjen dhe edukimin e tyre.

Të gjithë subjektet e interesuar, mund të paraqesin një kërkesë pranë KSHB në rrugë shkresore ose elektronike, në kontaktet si në vijim:

Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Adresë: Rruga “Mine Peza”, Pallati 87/3, Shkalla 2, Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@kshb.gov.al

Kërkesa tuaj do të shqyrtohet mbështetur në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe ju do të merrni përgjigje brenda afateve ligjore të përcaktuara.

PROCEDURA E ANKESËS

Në lidhje me veprimet ose mosveprimet e KSHB, ju keni të drejtë të paraqisni ankesën tuaj pranë KSHB, në portalin e bashkëqeverisjes, si dhe mund t’i drejtoheni gjykatës në afatet dhe sipas procedurave që rregullojnë gjykimin administrativ.

Ju mund të paraqisni ankesën tuaj në rrugë shkresore ose elektronike, në kontaktet si në vijim:

1. Komiteti Shqiptar i Birësimeve
Adresë: Rruga “Mine Peza”, Pallati 87/3, Shkalla 2, Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@kshb.gov.al
2. Portali i Bashkëqeverisjes
3. Gjykata Administrative Tiranë

Ankesa tuaj do të shqyrtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe ju do të merrni përgjigje brenda afateve ligjore të përcaktuara.